

Misioni i OSBE-së në Kosovë ndihmon femrat të kyçen në politikë

Edhe pse femrat përbëjnë më shumë se gjysmën e popullatës së Kosovës, është e paimagjinueshme pjesëmarrja e tyre e ulët në politikë dhe në jetën publike. Sipas Muradije Shehut nga organizata joqeveritare për femra “Hareja”, thelb i problemi janë stereotipet rreth rolit gjinor dhe pasojat e diskriminim të cilat vijnë si rezultat i tyre.

Problemet rurale

“Shumë njerëz mendojnë se femrat e kanë vendin në kuzhinë, ndërsa burrat janë të paraparë të merren me biznes dhe politikë”, thekson Shehu. “Gjendja më e rëndë është në vendet rurale dhe në qytetet e vogla. Atje femrat synojnë që në rastin më të mirë të bëhen punëtore të thjeshta”.

OJQ-ja që udhëheqë Shehu është aktive në rajonin e Prizrenit, dhe ka për qëllim ngritjen e punësimit të femrave përmes trajnimeve profesionale. Por Shehu fuqizimin politik të gruas e shikon edhe si një rrugë përpara. “Neve na duhen më shumë femra në pozita vendimmarrëse në mënyrë që ato mund të ndikojnë në ndryshim për të mirë”, thotë ajo.

Një pjesë e madhe e problemit është që diskriminimi në baza gjinore është diskutuar vetëm në nivel qendror në Prishtinë, ndërsa pasojat më tepër vërehen në zonat rurale.

Takimi në nivelin lokal

Me qëllim të ngritjes së profilit të femrës, më 9 maj të vitit 2008, misioni i OSBE-së ka ndihmuar në organizimin e një tryeze diskutimi në komunën e Rahovecit për mundësimin e pjesëmarrjes së femrës në jetën publike dhe politike.

“Ne kemi pasur për qëllim të mbledhim femrat nga të gjitha segmentet e shoqërisë dhe të pajtohemi për rekomandime konkrete për përmirësimin e pozitës së gruas në komunën tonë”, thekson Katarina Grbesa, përfaqësuese e ekipit komunal të zyrës së OSBE-së në Rahovec.

Tryeza e rumbullakët është organizuar në bashkëpunim me zyrën komunale për barazi gjinore, e cila ndihmon në implementimin e rekomandimeve. Janë mbledhur femra nga OJQ-të e gruas, deputetet në Kuvendin e Kosovës nga Rahoveci, si dhe këshilltare komunal.

“Ne kemi diskutuar për çështjet që na brengosin të gjithave”, thotë Vesna Mitasheviq, nga shoqata e grave “Jefimije” nga fshati Hoçë e Madhe.

Edhe pse Mitasheviq është një serbe dhe Shehu shqiptare nga Kosova, të dyja tregojnë se si ato përballen me një diskriminim të njëjtë si femra dhe mu për këtë ato punojnë për barazi gjinore. Ato citojnë statistikën e UNDP-së që tregojnë se vetëm një nga katër të punësuar në Kosovë – ku shkalla e papunësisë është 43% – janë femra.

Çka duhet të bëhet?

Rekomandimet kryesore nga takimi përfshijnë ma sa vijon:

- OSBE-ja duhet t'iu ofrojë trajnim grave të cilat veç janë të kyçura në punën e komunave në mënyrë që të përmirësojë shkathhtësitë e retorikës dhe lobimit;
- pjesëmarrëset duhet të bëjnë një kërkesë të përbashkët nga komuna për ngritje graduale të numrit të femrave që punojnë në organet ekzekutive dhe në pozitat vendimmarrëse;
- komuna dhe OJQ-të duhet të organizojnë takime me pronarë të bizneseve nga rajoni në mënyrë që të promovojnë punësimin e barabartë të femrave të kualifikuara; dhe
- pas shqyrtimit të buxhetit gjashtë-mujor, duhet të krijohet një fond komunal në mbështetje të OJQ-ve që përfshijnë femrat në vendet rurale.

Habibe Haxhimustafa, zyrtare për çështje gjinore, thotë se megjithëse rekomandimet janë ambicioze, ato nuk janë të paarritshme. “Ne duhet t’u përkushtohemi qëllimeve tona dhe përfundimisht do t’ia arrijmë”.

Përpjekje të përbashkëta

OSBE-ja do të ndihmoj drejtpërdrejt me rekomandime për trajnime, edhe do të monitoroj implementimin e rekomandimeve të tjera komunale. Adem Kollari, një zyrtar tjetër nga ekipi komunal i OSBE-së, thotë se zëvendësi i kryetarit të Kuvendit Komunal do të lloboj gjithashtu për këto rekomandime në seancat e Kuvendit.

“Sidoqoftë”, thotë Haxhimustafa, “femrat këshilltare nëpër komuna dhe të punësuarat do t’i kushtojnë shumë rëndësi avancimit të mundësive të barabarta dhe dhënies fund të diskriminimit”.

Në Rahovec janë bërë përpjekjet e para në Kosovë me qëllim të mobilizimit të femrave në nivelin komunal. Për momentin, mekanizmi i vetëm që inkurajon pjesëmarrje më të madhe politike të femrave është kuota prej 30% femra në sistemin zgjedhor.

Megjithatë, kjo kuota është larg nga realiteti. Nga 350 drejtor sa janë nëpër komuna të mbarë Kosovës, vetëm dy janë femra. “Dhe mu për këtë këshilltaret e zgjedhur nëpër komuna dhe deputetet në Kuvendin e Kosovës duhet vazhdimisht të llobojnë për të drejtat e femrave”, thotë Shehu. “Dhe ne te tjerët duhet t’i mbështesim ato”, përfundon ajo.

Shkruar nga Mustafa Skenderi